



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

PROJEKT VENDIM

Nr. 13730/3 datë 06/08/2025

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT VENDOR SOCIAL

2026-2028”

Në mbështetje të nenit 113 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 8 pika 2, neni 29 pika 1, Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030; Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024; Strategjia për PAK, barazinë gjinore, të moshuarit dhe grupet vulnerabël, Kuadri i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të) në nivel vendor. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026; Ligji Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”; Ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale”; Ligjin nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësit social”; Aktet nënligjore që rregullojnë shërbime specifike si: VKM për standardet e shërbimeve për fëmijë, për PAK, për të moshuar, viktimat të dhunës, etj.; Konventa ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, si Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Kryetari i Bashkisë i paraqet Këshillit të Bashkisë Lezhë;

PROPOZJ:

1. Miratimin e Planit Vendor të Veprimit Social 2026-2028.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar.

KRYETARI

Pjerin NDREU

NË MUNGESË DHE ME URDHER

ZV.KRYETAR

Brikena VUKSANI

